



Save the Children

MESUESI

# “Fëmijët dhe të rinjtë flasin”

NR 1 -- 2011

## Konflikti mes nxënësve, sa i shëmtuar?!



**D**ua t'iu tregoj një ndodhi që në orën e edukimit fizik në klasën tonë. Mësuesja na nxori jashtë në oborr për të zhvilluar orën e voleybollit.

Ne vajzat “u bindëm” sipas ndarjes që na bëri mësuesja dhe filluam lojën. Djemtë nuk donin të fillonin lojën pasi nuk e parapëlqenin ndarjen në skuadra që pat bërë mësuesja. Kjo situatë u bë aq e pakëndshme sa që filluan të grindeshin e ziheshin me njëri –tjetrin. Debatet dhe madje kërcënimet mes tyre u bënë serioze dhe nga një problem i vogël fare në dukje, u pa se u bë një goxha problem që tashmë duhet zgjidhur.

Ndërmorëm nismën në të Këshillit të klasës, por pa rendiment, as që bëhej fjalë për të shuar debatet.

Thirrëm mësuesen kujdestare dhe presidenten e senatit.

Vetë nxënësit e përfshirë në ngjarje sikur e shuan inatin, por mësuesja u “imponua” me një zë të lartë dhe me një gjuhë më shumë agresive dhe të dhunshme se sa me qeti dhe kujdes.

Dukej se situata tani ishte edhe më e vështirë për tu zgjidhur, pasi ajo kishte dalë nga muret e shkollës dhe kishte kaluar tek prindërit e nxënësve. Dihej tani se vetë në shokët e klasës dhe nxënësit vinim re që tek ne brenda shkollës ishin qetësuar gjërat, por përmasa e kaluar tek prindërit ishte edhe më shqetësuese për ne.

Ç'do kishte ndodhur nëse ne do ishim përpjekur vetë si klasë dhe këshill klase apo edhe qeveri e nxënësve për të zgjidhur zënkën pa kaluar në “dorë” të mësueses?

Me siguri do të kishin shuar më shpejt dhe më mirë....

**Ilisada Istrefi klasa e 8 Melan Peshkopi.**

## Pastërtia në klasë

**N**e të gjithë shkojmë në shkollë. Ne shkojmë në shkollë për të mësuar gjëra të reja. Ne formojmë atje grupe shoqërore që janë shumë të forta dhe ekzistojnë edhe pasi në jemi larguar nga shkolla dhe kemi gjetur rrugë të tjerë në jetë.

Por për të qenë sa më të ditur na shërbejnë lëndet e mësimit që ndjekim dhe mësimit që mësojmë. Jemi të përkushtuar dhe të vëmendshëm ndaj mësimit dhe mësuesve tanë që të përfitojmë sa më shumë gjatë shpjegimit të tyre në klasë. Por



## Mbrojtja nga lëndët narkotike si droga e alkooli

**L**ëndët narkotike dhe përdorimi i tyre prej njerëzve dhe sidomos prej nxënësve dhe të rinjve është një nga problemet më të mëdha dhe më të vështira që haset në shkollat tona.

Në të vërtetë unë vetë nuk kam hasur ndonjë rast të tillë të drejtpërdrejtë ku dikush prej miqve e shokëve të mi të jetë përdorues i drogës. Por kjo nuk do të thotë se ky fenomen nuk ekziston diku gjetkë.

Droga, alkool dhe duhani janë të dëmshme dhe të rrezikshme për shkollën tonë. Le të kthehem tek duhani, që është dhe më i dukshëm, nëpër oborret e shkollave tona. Atë e përdorin mjaft të rinj sidomos të shkollave të mesme. Mua

nuk më pëlqen kur i shikoj që të tymosin nëpër cepat e shkollës. Ka nga ata që e bëjnë dhe fare hapur në sy të mësuesve dhe nuk i gjen gjë. Thua se janë të padukshëm?

Ç'duhet të bëjë shkolla në këtë rast dhe qeveritë e nxënësve.

Unë them se ata duhet t'i venë këta duhanpirës me shpatulla pas murit dhe t'i gjykojnë ashpër. Nëse duan ta përdorin këtë gjë le ta bëjnë në një moshë tjetër kur të jenë jashtë dyerve të shkollës sonë

Prandaj le të mblidhemi të gjithë në një mendim dhe t'i themi ndal drogës, alkoolit dhe duhanit. **Ervis Rapushaj Shkolla “Eqerem Beqiri” Kotë Vlorë**

jo gjithmonë e kemi këtë mundësi dhe komoditet pasi shpesh ka në klasat tona nxënës që bëhen të vështirë me zhurmat dhe rrëmujën që krijojnë në klasë.

Bëjnë zhurmë dhe gjuajnë njëri –tjetrin me sende nga më të ndryshmet. Thyejnë mjetet e shkrimit si stilolapsat dhe bëhen aq problematikë sidomos në disa orë dhe lëndë të veçanta sa që shqetësojnë gjithë klasën.

Kulmi arrihet sidomos gjatë pushimeve të vogla midis orëve, kur në mungesë të mësuesve klasa gati kthehet në një shesh lufte ku ndeshen gladiatorët. Në këto pushime bëhet thuajse e pamundur të qëndrosh në klasë midis një reje pluhuri që ngrihet deri në tavan dhe dëmton shëndetin tonë.

Jemi vërtet të shqetësuar për këtë sjellje në klasë dhe po përgatitemi që këtë çështje ta ngremë në mbledhjen më të parë të qeverisë së nxënësve dhe të kërkojmë ndihmën e tyre. Shpresojmë që të përmirësojmë diçka dhe atëherë do t'ju kemi shkruar përsëri.

**Daniela Baçe Shkolla “Urani Rumbo” Gjirokastër.**



## “PJESEMARRJA

**Aktivitetet tona kanë qenë të shumta dhe të gjitha kanë patur si qëllim forcimin e rolit të Qeverisë së Nxënësve, fuqizimin e saj dhe mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në shkollë, por pse jo dhe jashtë saj, duke patur parasysh aktivitetet që kemi zhvilluar.**

# Qeveria e nxënësve, nismëtare e aktiviteteve në qytetin gri të Gjirokastrës

**N**e, që po ju shkruajmë, jemi pjesë e rrjetit të Qeverisë së Nxënësve në rrethin e Gjirokastrës, të cilët jemi fatmirësisht pjesëtarë të 10 shkollave ku pilotohet projekti i “Qeverisë së Nxënësve” nga organizata Save the Children.

Aktivitetet tona kanë thyer disi qetësinë e qytetit tonë që shquhet për ngjyrën e tij tradicionale, gri, për arkitekturën e veçantë, dashurinë për arsimit dhe mbi të gjitha iniciativat që kanë nxënësit e shkollave të rrethit tonë.

Aktivitetet tona kanë qenë të shumta dhe të gjitha kanë patur si qëllim forcimin e rolit të Qeverisë së Nxënësve, fuqizimin e saj dhe mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në shkollë, por pse jo dhe jashtë saj, duke patur parasysh aktivitetet që kemi zhvilluar.

Po ju tregojmë disa veprimtari të cilat kemi zhvilluar gjatë muajit mars 2011.

Siparin e këtyre aktiviteteve në muajin mars e hapi aktiviteti i Festimit të Karnavaleve me tematikë “E drejta për t’u shprehur lirshëm”. Aktiviteti

startoi nga 10 shkollat duke gumëzhitur rrugëve të qytetit, me destinacion Drejtorinë Arsimore Racionale Gjirokastrë, e cila ndodhet në kërthizë të qytetit, ku pjesëtarë të Qeverive të Nxënësve u takuan me titullarin e DAR-it, z.Arjan PANO.

Ne kishim shumë pyetje që ja drejtuan drejtorit, duke patur parasysh se shkolla është institucioni që formon qytetarinë demokratike të bashkëmoshatarëve tanë, kudo ku janë dhe mjediset e saj janë në funksion të edukimit të të drejtave të fëmijëve dhe të qytetarëve të së nesërme.

Drejtori ju përgjigj të gjithë nxënësve me premtimin se do të bëjë një punë të vazhdueshme me të gjithë aktorët e edukimit, veçanërisht me drejtuesit e shkollave dhe mësuesit, për të reflektuar në mënyrë kritike ndaj atyre që shkelin të drejtat e fëmijëve, si dhe na dha fjalën se do të hartojë një plan masash për të përmirësuar të drejtat e fëmijëve në shkollë duke e shtrirë bashkëpunimin me prindërit dhe komunitetin.

Aktiviteti që pasoi atë të Karnavaleve ishte

ai i Flamurtarëve të shkollës, që u zhvillua në kuadrin e 7 Marsit, Ditës së Mësuesit, ku Qeveritë e Nxënësve, në bashkëpunim me mësuesit koordinatorë dhe drejtoritë e shkollave shoqëruan Flamurtarin e Shkollës së tyre, i cili është nxënësi që ka arritjet më të larta në procesin mësimor dhe edukativ, nxënësi që shfaq etikë dhe marrëdhënie të mira komunikimi dhe bashkëpunim të punës në grup, që është pjesë e procesit të të nxënësve, si proces në zhvillim dinamik, duke mos e parë të shkëputur nga jeta sociale e shkollës, që shquhet për veprimtar vullnetar në aktivitete specifike të shkollës, që pranon diversitetin e shokëve dhe i vlerëson ata.

Flamurtarët e Shkollës të përzgjedhur në këtë mënyrë, ku ne jemi pjesë e grupit të punës, shoqërohen nga flamuri i Qeverisë së Nxënësve, që dallon çdo Qeveri Nxënësish në rrethin tonë dhe nga tre breza mësuesish të shkollës:

Tre mësues veteranë, tre mësues që kanë mbi 10 vjet punë në shkollë, tre mësues të rinj duke gërshtuar në këtë mënyrë punën e Qeverisë së Nxënësve dhe duke marrë model traditë dhe përcjelljen e stafetës në brezat e rinj.

Aktivitetet sensibilizues në kuadër të “Javës kundër Diskriminimit Racial”, do të pasojnë aktivitete të lartpërmendura, ku ne e shohim veten pjesë të besimit të atyre bashkëmoshatarëve që janë në luftë kundër diskriminimit dhe paragjytimeve racore.

Kështu në u nisëm drejt Institucionit të Prefektit, ku na priti Sekretari i Përgjithshëm i Prefekturës, Z. Pandeli TOLI, të cilit i drejtua këto pyetje, të cilat i përgatitëm në një takim të veçantë të punës sonë:

1. Mjedihi shkollor dhe or-

Aktivitetet tona kanë thyer disi qetësinë e qytetit tonë që shquhet për ngjyrën e tij tradicionale, gri dhe për arkitekturën e veçantë



ganizmat në funksion të saj kanë në qendër respektimin e të drejtave të fëmijëve, por shpeshherë në shkollat tona shumë fëmijë ndihen të mënjanuar nga mësuesit, duke ju shkelur këto të drejta. A jeni ndjerë ndonjëherë e mënjanuar Ju dhe cili është mesazhi që u përcillni mësuesve që i lënë nxënësit të mënjanuar?

2. Ju përfaqësoni një institucion, i cili është hallkë lidhëse mes pushtetit vendor dhe qendror, por në disa shkolla nuk ka rrethim dhe në disa të tjera ka dalje të menjëhershme në rrugë kryesore, duke vënë në rrezik sigurinë e bashkëmoshatarëve tanë. A kemi premtimin tuaj se do të ndërhyri për zgjidhjen e këtij problemi?

3. Në disa shkolla të zonave rurale, pse jo dhe në qytet edhe pse përpiqemi të bëjmë më të mirën si Qeveri Nxënësish, por s'kemi mbështetjen dhe besim e disa mësuesve dhe shumë prindërve. A keni ndonjë mesazh për t'ju drejtuar atyre për të mbështetur punën tonë?

4. Cila është dora mbështetëse e Institucionit të Prefektit në lidhje me fëmijët me AK, fëmijëve romë dhe atyre në vështirësi ekonomike?

5. A keni Ju informacion periodik mbi ecurinë e mësimdhënies? Ç'mund të na thoni në lidhje me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në zonat rurale?

6. Një e drejtë e jona është dhe argëtimi, a mund të kemi ndërhyrjen tuaj për parqe dhe kënde lojërash për ne?

7. Ne fëmijët kemi një bashkëjetesë të mirë midis nesh, për sa i përket bashkëjetesës fetare, kulturore, gjuhësore, por shpesh ne hasim në shumë pengesa të prindërit, të cilët shpesh kanë disa tabu në mendime. Ju jeni dhe prind. Duam të dimë a i keni shkelur ndonjëherë të drejtat e fëmijëve Tuaj dhe çfarë i përcillni Ju komunitetit gjirokastrit në lidhje me sa thamë?

8. Diskriminimet dhe paragjykimet ekzistojnë, megjithëse përpiqemi të gjithë për t'i minimizuar me qëllim zhdukjen. Shumë bashkëmoshatarët tanë vetëdiskriminohen për shkak të gjendjes ekonomike. Kjo u pa edhe te blerja e librave. Cila është premtimi që u bëni Ju atyre,



kryesisht fëmijëve të komunitetit romë?

9. Ne dëshirojmë të kemi korrespondencë me zyrën tuaj rreth shqetësimeve që hasim në rastet e shkeljes së të drejtave tona, a mund t'ju kemi mbështetje?

Z. Toli jo vetëm që ju përgjigj gjithë pyetjeve tona, por na premtoi se do t'ju drejtohet të gjitha njësitë të pushtetit vendor, institucioneve të ndryshme dhe atyre shkollore me një "Letër informuese" rreth shqetësimeve të përcjella nga rrjeti i Qeverisë së Nxënësve.

Në fashëtat dhe pankartat që përshkuan qiellin, shoqëruar me tullumbace shumëngjyrëshe që simbolizojnë ndryshueshmërinë e ngjyrës së lëkurës sonë, për sensibilizimin e gjithë opinionit gjirokastrit lexoheshin mesazhe të tilla si:

- Jemi fëmijë në çdo cep të botës, pavarësisht tipareve që kemi meritojmë të trajtohemi të barabartë.
- Mirëkuptimi fillon nga Ti, vjen tek Unë dhe duhet përcjellë tek të Gjithë.
- Të gjykosh duke parë tiparet e lindura nuk ka



kuptim në asnjë lloj kulture.

- Jo vetëm unë, Jo vetëm Ti, por të gjithë së bashku mund të realizojmë misionin "Barazi".
- Forcë dhe kurajë, jemi pjesë e nismëtarëve të barazisë njerëzore.
- Racizmi është një bimë, nëse s'e ujitim s'do

Flamurtarët e Shkollës,  
ku ne jemi pjesë e grupit  
të punës, shogërohen  
nga flamuri i Qeverisë së  
Nxënësve, që dallon çdo  
Qeveri Nxënësish



të zhvillohet.

- Të gjithë jemi të ndryshëm, të gjithë të barabartë.
- Thuajti jo racizmit, kulmit të urrejtjes pa arsye.
- Racizmi është injorancë dhe jo pjesë e njerëzve të shkolluar.

Mes nesh në këto aktivitete ishin me dhjetëra bashkëmoshatarë tanë të shkollave 9-vjeçare, mësues, prindër edhe pjesë të komunitetit të kulturuar gjirokastrit dhe media e cila përcolli në TV- lokale gjithë aktivitetet tona

Ndryshimi fillon nga vetja, ne jemi pjesë e ndryshimit të madh.

Aktivitetet vazhdojnë.....Ju do të na lexoni përsëri.....

**Përgatitur nga: Rrjeti i Qeverive të Nxënësve-Gjirokastër**

## Gjelbërimi i shkolles "Fadil Gurmani"



Shkolla "Fadil Gurmani" ka kryer nje veprimtari mbi gjelberimin e oborrit te saj me bashkeveprimin e te gjithe nxenesve te kesaj shkolle dhe punen e tyre te palodhshme qe kane bere te drejtuar nga mesuesit e tyre kujdestare. Ka qene nje aktivitet mjaft i bukur duke qene se secili nxenes zhvillonte punen e kerkuar ne forme konkurimi me te tjeret. Aktiviteti kerkonte hapjen e gropave per t embjelle fidane. Secila klase kishte per te mbjelle nga nje fidan dhe secila duhet te punonte ne hapjen e gropave te thella per mbjelljen e tyre. Ishte nje bashkepunim interesant sepse secila klase kerkonte gropen me te mire per te thelluar dhe fidanin e konsideronin si simbol te klases se tyre qe do te mbetej aty. Fondet e shkolles mjaftuan ne kompletmin me fidane te kopshtit edhe qeveria e nxenesve kontriboi ne organizimn e punes se bashku me keshillin e mesuesve. Keshtu edhe nxenesit kaluan caste te bukura te ndryshme nga ato mesimore . Falenderojme organizatoret e ketij aktiviteti.



# PANAIRI I USHQIMIT

Ne date 3 shkurt ne si QN organizuam panairin e ushqimit. Te gjithe ne senatoret u angazhuam qe ne te gjitha klasat te kete nje pjesmarrje sa me te larte dhe te gatuanim gjera te vecanta dhe me te vertete speciale. Nx e shkolles sone vijne nga fshatra te ndryshme si: Bathsi, Shirgjani, Mjeksi dhe Kuqani dhe u munduam te sjellim gatime tipike te zonave tona dhe te Elbasanit. Te gjithe punuan me perkushtim qe aktiviteti te dilte sa me i bukur dhe te kishte pjesmarrje te larte, madje u sollen gatime edhe nga nxenes qe qe nuk shkojne mire me mesime por qe u ndjene mjaft te vleresuar ne kete aktivitet. Pervec se nxenesve gatimet tona u shijuan dhe u blene edhe nga mesuesit e shkolles qe pasi i provuan te tera dhane edhe vleresimet e veta per ato ushqime qe pelqyen me shume. Ne fund ne nuk lame pa dhene vleresimet perkatese per klasat e angazhuara dhe te impenjuara me shume si p.sh: klasa e 8 a kishte bere torten me molle me te mire te gatuar nga Sara Cakalli, klasa 9 a kishte ide te vecante ne gatimin e disa biskotave ne forme shkronjash te bera nga Xhoni Bica, klasa 7 b mori nje vleresim te vecante per mbi 6 lloje te ndryshme gatimi edhe pse vijne nga zona me varfer sic eshte Mjeksi, ata kishin gatuar qumeshtur te pjekur, kek, petulla te fshira , byreke te palosur, kroasan te mbushur me recel etj, vajzat e klases 7 a gatuan ate qe e quajten keku special per nga menyra e zbukurimit qe i kishin bere



edhe trigona me kadaif.

Ne nuk lame pa pershendetur dhe falenderuar edhe prinderit tane qe me aq perkushtim u treguan te

gatshem per te realizuar ushqimet e shumllojshme qe pa ndihmen e tyre nuk do ta realizonim dot kete aktivitet te vecante. Parate qe u mblodhen



nga shitja e ushqimeve i kaluam si fond te QN.

**Desara Cekrezi, Qeveria e nxenesve, Shkolla 9-vjecare Kuqan**

## Nje vend i humbur diku ne kujtесе

Mbas kaq vitesh ti ndodhesh serisht aty. Aty ku filloj nje pjese e rendesishme e kuptimit te jetes, e kuptimit te dashurise.

Ti druhash, druhash se mos kujtimet jane tretur, se mos nuk ndien asgje. Menjehere sa shkele gjithcka u shenderrua, kujtimet e argjendta rikthehen e ti zgjedh me te bukurat, por jo vetem, ti zgjedh me te dashurat. Ja ku eshte plepi i mbushur me kenget e jashtezakonshme te zogjve, ja ku eshte gurresa me ujin e kristalte e me gurgullimen e saj te perhershme. Tani sic je ashtu e etur per uje zgjat grushtet e sndien te ngopur. Ujet e ftohte nuk mund te te ftohin me si dikur, por perkundrazi te dhurojne ate ndiesine e deshires per te pire me shume, me shume e akoma me shume. Hija e nje shtepije aty prane te terhoqi, porsi magnet. Ishte aty sikur te ishte dje;

ajo shtepi dykateshe, me rrasa guri te medha, me penxhere te vogla vende vende te mbuluara me myk. Valle sa kohe ka kaluar? Humbe kuptimin e kohes.

Mendon... Sa mire do te ishte sikur ta shihje serisht, sikur te mund ti flasesh, ta kujtosh, ta prekesh, ta duash. Ta duash aq shume e akoma me shume se ce deshe. Ti atehere e deshe, e deshe ne menyren tende feminare, e deshe duke mendar se ajo do te ishte aty duke te te pritur duke te te buzeqeshur. Gabove...nje tjetër gabim midis qindra gabimeve te deritanishme . Ajo shkoj shkoj perpara. Shkoj duke lene nje pjese te saj te ty. Shkoj duke e ditur se do te jetonte ne zemren e te gjithëve ne mendjen e te gjithëve. Tashme kane kaluar plot njembdhjete vjet papranine e saj. E sot eshte e para here qe ti ndi-

hesh ndryshe. E para here qe ti sdo te flasesh me per te sikur te kishte shkuar. Cfare sdo te beje per ta pare edhe njehere?! Ajo eshte kaq prane ti arrin ta ndiesh pranine e saj. Ar- rin ta shohesh ulur aty ne qoshk me fytren te mbushur me nota te embla pritjeje, me shenja malli, dashurie dhe ja me ne fund buzeqeshja. Ajo buzeqeshje e embel qe dinte ta bente kaq mire per mbesen e saj. E ti, ti vrapon si e marre per ta perqafuar, per ta mbytur ne puthje, per ta ndier ngrohtesine e saj. Afrohesh zgjat doren, imazhi zhduket, tretet e bashke me te tretet buzeqeshja jote, humbet ngrohtesia. Ti tashme ke ftohte, zemra e syte lotojne e si per cudi kujtimi vazhdon te mbes aty duke te te lejuar ty ta hapesh, ta shohesh ta ndiesh sa here qe e ndien me te vertet.

**Elisa Baku, Gramsh**



-Save the Children

në Shqipëri ju uron të gjithë mësuesve dhe nënave shqiptare Gëzuar festat e 7-8 marsit. Faleminderit për përkushtimin dhe kontributin tuaj ndaj edukimit dhe zhvillimit të fëmijëve në Shqipëri.